



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

KONCEPT DOKUMENTI PËR FINANCAT E PUSHTETIT LOKAL

Përgatitur nga Ministria e Financave
Mars - Shtator, 2018

Përmbajtja

Përmbledhje e koncept dokumentit.....	Error! Bookmark not defined.
Hyrje.....	Error! Bookmark not defined.
Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit.....	Error! Bookmark not defined.
Kapitulli 2: Objektivat.....	Error! Bookmark not defined.
Kapitulli 3: Opsionet.....	Error! Bookmark not defined.
Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim	Error! Bookmark not defined.
Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit... Error!	Bookmark not defined.
Kapitulli 3.3: Opsioni për hartimin e Projektligjit të ri për Financat e Pushtetit Lokal. Error!	Bookmark not defined.
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme	Error! Bookmark not defined.
Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave.....	Error! Bookmark not defined.
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi	Error! Bookmark not defined.
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve	Error! Bookmark not defined.
Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme.....	Error! Bookmark not defined.
Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet	Error! Bookmark not defined.
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm.....	Error! Bookmark not defined.
Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin	Error! Bookmark not defined.
Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik	Error! Bookmark not defined.
Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore	Error! Bookmark not defined.
Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore	Error! Bookmark not defined.
Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore.....	Error! Bookmark not defined.

Koncept Dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal

Përmbledhje e koncept dokumentit

Informacionet e përgjithshme	
Titulli	Koncept Dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal
Ministria bartëse	Ministria e Financave
Personi kontaktues	Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Ministria e Financave Kontakti: 0 200 34 259
PVPQ	Nuk ndërlidhet me ndonjë obligim specifik në PVPQ, por në mënyrë indirekte ndihmon në përmbushjen e veprimeve që ndërlidhen me arsimin, shëndetësinë dhe shërbimet sociale.
Prioriteti strategjik	Ndërlidhet me disa prioritetë strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Vendimi	
Çështja kryesore	Trajtimi i problemeve ekzistuese në sistemin e financave lokale të Republikës së Kosovës
Përmbledhje e konsultimeve	<p>Marrë parasysh përvojën e Ministrisë së Financave në zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108, si dhe bazuar në ndryshimet që kanë ndodhur në sistemin juridik të e Republikës së Kosovës që ndërlidhen me financat e pushtetit lokal, Ministria e Financave ka parë të arsyeshme që të trajtojë me Koncept Dokument këtë fushë.</p> <p>Me qëllim të gjithë përfshirjes së institucioneve të Republikës së Kosovës dhe palëve tjera të interesit, Grupi Punues për Koncept Dokument ka përfshirë përfaqësues nga ministrinë e linjës, niveli komunal dhe shoqëria civile që kanë në fokus financat e pushtetit lokal.</p> <p>Përgjatë konsultimeve paraprake, të cilat janë mbajtur nga data 31.07.2018 deri më 22.08.2018, janë pranuar këto komente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Policia e Kosovës ka kërkuar që një pjesë e të hyrave që mbledhen nga gjokat e trafikut të derdhet për nevojat e këtij institucioni si dhe të ketë kompetenca që të jetë kreditor në këtë procedurë, meqë kjo do të mundësonte përmbarrimin e shpejtë të këtyre lëndëve; 2. Ministria e Punëve të Brendshme ka kërkuar që të saktësohet terminologjia e përdorur për njësitin e zjarrfikësve, ka kërkuar fond specifik për menagjimin e emergjencave, ka kërkuar procedimin më të shpejtë të legjislacionit për këtë fushë dhe ka kërkuar që të reflektohen ndryshimet e fundit lidhur me trajtimin e aseteve të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave. 3. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar që në problemin e trajtuar të kompetencave të centralizuara, të ceket edhe çështja e kompetencave të decentralizuara. 4. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka kërkuar që të trajtohet çështja e inspektorëve ushqimor.

Koncept Dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal

	<p>5. Agjencia për Barazi Gjinore ka kërkuar që të reflektohet në koncept dokument ndikimi gjinor dhe në të drejtat e njeriut.</p> <p>6. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka konfirmuar që nuk ka komente për Koncept Dokumentin.</p> <p>Përgjatë konsultimeve publike, të cilat janë mbajtur nga data 23.08.2018 deri më 19.09.2018, janë pranuar këto komente:</p> <p>1. Koalicioni i Organizatave për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF) ka kërkuar që të krijohet një grant specifik për shërbimet sociale të llojit të mbyllur.</p> <p>Pas mbyllje së afatit të konsultimeve publike, Ministria e Financave ka pranuar komente shtesë, të cilat për shkak të kërkesës për trajtim urgjent të këtij Koncept Dokumenti nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nuk kanë mundur të trajtohen, por që do të merren seriozisht gjatë hartimit të Projektligjit për Financat e Pushtetit Lokal, në rast të aprovimit të opsionit të rekomanduar nga ky Koncept Dokument.</p> <p>Lista e komenteve të pranuar dhe trajtimi i tyre i është reflektuar në Shtojcën Nr. 5 të këtij Koncept Dokumenti.</p>
Opsioni i propozuar	<p>Opsioni i tretë vlerësohet si i preferuar, ndaj Grupi Punues rekomandon hartimin e Projektligjit të ri me të cilin do të shfuqizohet Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108.</p> <p>Ky opsion i rekomanduar është elaboruar në detale tek Kapitulli 3: Opsionet.</p>

Ndikimet kryesore të pritshme	
Ndikimet buxhetore	Opsioni i propozuar në këtë Koncept Dokument nuk krijon kosto shtesë buxhetore dhe zbatohet në kuadër të kufijve aktual buxhetor. Por, kosto shtesë buxhetore mund të krijohet vetëm nëse MTI dhe AVUK-hapin zyre rajonale për inspektorët përkatës pasi të transferohen në nivel qendror. Gjithashtu kosto shtesë buxhetore mund të krijohet nëse rriten/harmonizohen koeficientët për zjarifikësit gjë që është paralajmëruar nga Qeveria, por vendim formal nuk ka ende.
Ndikimet ekonomike	Opsioni i propozuar në këtë Koncept Dokument nuk do të ketë ndikim në ekonomi
Ndikimet shoqërore	Opsioni i propozuar në këtë Koncept Dokument nuk ka ndonjë ndikim të të drejtpërdrejtë shoqëror. Ndikimi është i tërthortë nëpërmjet grantit specifik social
Ndikimet mjedisore	Opsioni i propozuar në këtë Koncept Dokument nuk do të krijojë ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis. Ndikimi është i tërthortë nëpërmjet definimit të të hyrave vejtake, që siguron zbatimin e Ligjit për Obiliqin.
Ndikimet ndër-sektoriale	Opsioni i propozuar në këtë Koncept Dokument nuk do të ketë ndonjë ndikim ndër-sektorial.

Koncept Dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal

Ngarkesat administrative për kompanitë	Opsioni i propozuar në këtë Koncept Dokument nuk krijon ngarkesa administrative për kompanitë.
Testi i NVM-ve	Marrë parasysh fushën e trajtimit të këtij Koncept Dokumenti, Grupi Punues vlerëson se nuk ka nevojë që të zhvillohet testi i NVM-ve.

Hapat e ardhshëm	
Afatshkurtër	Me rastin e aprovimit të Koncept Dokumentit me opsionin e rekomanduar, brenda një viti do të draftohet Projektligji i ri për Financat e Pushtetit Lokal nga ekipi i themeluar nga Ministria e Financave, në bashkëpunim me të gjithë palët e interesit.
Afatmesëm	Me rastin e aprovimit të Koncept Dokumentit me opsionin e rekomanduar, pas një viti pritet të miratohet Ligji i ri dhe të hyjë në fuqi më 1 janar 2020. Nga dy deri në pesë vitet e ardhshme, do të sigurohet zbatimi i përpiktë i Ligjit të ri, nëpërmjet mekanizmave adekuat dhe akteve nënligjore (nëse është e nevojshme).

Hyrje

Sistemi i financave lokale është një nga shtyllat kryesore të funksionimit të pushtetit lokal. Ministria e Financave si dikaster i Qeverisë së Republikës së Kosovës, vend të veçantë dhe shumë të rëndësishëm i ka kushtuar aktiviteteve që mundësojnë efikasitet sa më të lartë në fushën e financave lokale. Mëtimi i Qeverisë është që të sigurohet një sistem i zhvilluar i financave lokale në mënyrë që komunat të mund të ushtrojnë kompetencat dhe realizojnë aktivitetet e tyre në mënyrë efikase dhe efektive.

Ministria e Financave është përgjegjëse për krijimin e kornizës ligjore për fushën e financave lokale. Në kuadër të strukturës organizative të Ministrisë së Financave është Departamenti i Buxhetit, që është përgjegjës për hartimin e politikave buxhetore dhe të financave të pushtetit lokal. Ministria e Financave deri më tani ka bërë përpjekje për të adresuar problemet e ngritura nga organet qendrore dhe komunat, mirëpo këto çështje nuk mund të adresohen pa trajtimin e Ligjit të Financave të Pushtetit Lokal.

Figura1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	Koncept Dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal
Ministria bartëse	Ministria e Financave – Departamenti i Buxhetit
Personi kontaktues	Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Ministria e Financave Kontakti: 0 200 34 259
PVPQ	Nuk ndërlidhet me ndonjë obligim specifik në PVPQ, por në mënyrë indirekte ndihmon në përmbushjen e veprimeve që ndërlidhen me arsimin, shëndetësinë dhe shërbimet sociale.
Prioriteti strategjik	Ky Koncept Dokument ndërlidhet ngushtë me objektivat strategjik të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Konkretisht, ky koncept dokument adreson kërkesën e Strategjisë për Vetë Qeverisje Lokale 2016 - 2026, në lidhje me komponentin e ndryshimit të bazës ligjore të financimit të komunave, dhe kërkesën e Strategjisë Sektoriale për të Shëndetësisë 2017 -2021, në lidhje me komponentin e sigurimit të burimeve financiare për grantin për shëndetësi.
Grupi punues	Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Zyrtar Përgjegjës, Fetije Begolli, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar; Fehmi Zylfiu, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, anëtar; Arsim Qavdarbasha, Ministria e Shëndetësisë, anëtar; Mentor Morina, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, anëtar; Sazan Ibrahim, Asociacioni i Komunave të Kosovës, anëtar; Besnik Muçaj, Instituti i Kosovës për Qeverisje Lokale, anëtar; Enis Spahiu, Ministria e Financave, anëtar; Berat Thaqi, Instituti GAP, anëtar; dhe Përfaqësues i Projektit DEMOS, anëtar.
Informata shtesë	Nuk ka informata shtesë

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Financat e pushtetit lokal janë të rregulluara me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal. Gjatë analizës së funksionimit të financave të pushtetit lokal, janë identifikuar disa çështje të cilat kanë nevojë të trajtohen. Problematikat e identifikuara gjatë zbatimit të Ligjit të Financave të Pushtetit lokal janë paraqitur si në vijim:

1. **Financimi i kompetencave të centralizuara** - komunat vazhdojnë të financojnë disa kompetenca të cilat tashmë janë bartur në nivel qendror si: njësi profesional i zjarrfikës dhe shpëtimit, inspektorët e tregut, inspektorët sanitar, veterinar dhe të bujqësisë-fitosanitar, etj. Ekziston nevoja për një përcaktim të qartë çfarë ndodh me financimin e atyre funksioneve të cilat barten nga niveli lokal në nivel qendror. Edhe pse Ligji për Menaxhimin e Financave Publike ka paraparë që në rast të bartjes së kompetencave të bartet edhe buxheti, në kontekstin e financave lokale kjo nuk ka gjetur zbatim, meqë ka ndikuar në totalin e grantit të përgjithshëm.
2. **Definicioni i të hyrave vetjake komunale** - Ligji ekzistues për financat e pushtetit lokal definon të hyrat vetjake komunale si të gjitha shumat e parave publike të cilat janë shqiptuar dhe janë mbledhur në mënyrë të ligjshme nga komuna. Është e nevojshme që ky definicion të pasurohet duke theksuar se të hyrat vetjake të komunave janë gjithashtu shumat e parave publike të cilat janë shqiptuar, mbledhur dhe pranuar nga burimet e përcaktuara në dispozitat ligjore.
3. **Planifikimi i të hyrave vetjake komunale** - ky planifikim të bëhet në përputhje me ligjin, duke marrë për bazë parametra të caktuar dhe duke marrë parasysh historinë e inkasimit të të hyrave vetjake komunale në tri vitet e kaluara, por duke vendosur një objektiv real të rritjes për çdo vit për çdo komunë me qëllim të rritjes së qëndrueshmërisë së financimit të komunave.
4. **Përfaqësimi efikas i komunave në Komisionin e Granteve** - Dialogu në mes të qeverisë qendrore dhe asaj lokale rreth financave lokale është dizajnuar të zhvillohet përmes Komisionit të Granteve. Komisioni i Granteve duhet të fuqizojë përgatitjet teknike në mënyrë që të përkrahët një vendim-marrje e bazuar në informacion të mirë. Komunitat përfaqësuese në Komision të Granteve duhet të zhvillojnë konsultime paraprake me të gjitha komunat para vendimmarrjes në Komision të Granteve.
5. **Investimet e nivelit qendror në nivel komunal** - Investimet në nivel komunal bëhen edhe nga niveli qendror. Madhësia e disa investimeve kapitale nënkupton që komunat të mos kenë mundësi t'i mbulojnë ato, megjithatë, vendimet individuale të marra nga ministrinë e caktuara gjenerojnë rrezik për investime disproporcionale nëpër Kosovë. Prandaj, me rastin e realizimit të projekteve nga niveli qendror në atë komunal kjo duhet të bëhet përmes kriterëve të qarta, të drejta dhe transparente.
6. **Granti specifik për shërbime sociale** - analiza e gjendjes për shërbime sociale dhe rezidenciale ka nxjerrur përfundimet se fusha e shërbimeve sociale dhe familjare deri me tani nuk është trajtuar si prioritet nga autoritetet komunale si dhe pamjaftueshmëri të fondeve të alokuara dhe planifikuara për mbulimin e kostos së standardeve

Koncept Dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal

minimale për ofrimin e shërbimeve sociale. Kosova vazhdon të jetë në një nivel të ulët në ofrimin dhe financimin e këtyre shërbimeve në krahasim me vendet në rajon dhe shumë më poshtë niveleve evropiane. Për të plotësuar nevojat dhe kërkesat në rritje për shërbime sociale dhe për të zbatuar standardet minimale të ofrimit të shërbimeve sociale duhet të krijohet një Grant specifik për shërbime sociale, i cili do të bazohet në disa indikatorë social dhe me parime të përafërta të grantit shëndetësisë dhe arsimit.

7. Granti specifik për Arsim dhe granti specifik për Shëndetësi – sistemi dhe rregullat ekzistuese për ndarjen e granteve specifike për Arsim dhe Shëndetësi nuk janë treguar të përshtatshme dhe adekuate. Prandaj, nevojitet zhvillimi dhe avancimi i standardeve dhe kritereve nga ministritë e linjës për këto dy lloj grantesh.
8. Qëndrueshmëria e komunave të vogla – Me qëllim të sigurimit të ofrimit të nivelit minimal të shërbimeve komunale, Qeveria e Republikës së Kosovës për një periudhë kalimtare deri në vitin 2019, ndan 2.7% të grantit të përgjithshëm për komunat që kanë popullsi më pak se njëzet e dy mijë (22,000) banorë. Prandaj, sistemi i financimit të komunave duhet të sigurojë një zgjidhje të qëndrueshme për këtë çështje.

Sa i përket legjislacionit të BE-së, në fushën e financave të pushtetit lokal nuk kemi ndonjë akt të BE-së që do të duhej të transpononim në sistemin tonë juridik dhe kjo kompetencë mbetet në kuadër të kompetencave të shteteve anëtare.

Në anën tjetër, si standard ndërkombëtar, në këtë fushë kemi Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, e Këshillit të Evropës, instrument i cili kërkon që niveli lokal, ndër tjerash, të ketë të garantuar financimin adekuat, të ketë të drejtë të përcaktojë taksat brenda territorit të komunës. Opsioni i propozuar me këtë Koncept Dokument ruajnë këtë të drejtë të komunave.

Figura 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore

Dokument i politikave, ligj ose akti nënligjor	Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare	Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim	Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)
Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2525	Ministria e Financave dhe Komunitat	Zbatojnë dispozitat ligjore
Ligji Nr. 05/L-108 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12761	Ministria e Financave dhe Komunitat	Zbatojnë dispozitat ligjore

Koncept Dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal

Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim – ndryshimet)	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524	Ministria e Financave dhe Organizatat Buxhetore	Zbatojnë dispozitat ligjore
Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2530	MAPL, Komunitat, Ministrinë e linjes	Zbatojnë dispozitat ligjore

- Ligji për Financat e Pushtetit Lokal rregullon çështjen e financimit të komunave duke u mbështetur në Kapitullin IV, neni 65, pika 1, si dhe Kapitullin X, neni 124, pika 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. LFPL njih nevojën për përcaktimin e burimeve financiare të cilat janë në dispozicion të komunave në Kosovë, duke përfshirë të hyrat vetanake komunale, grantet dhe burimet e tjera financiare të nevojshme për ushtrimin e kompetencave komunale.
- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale themelon bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. Ligji përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brenda komunale dhe bashkëpunimin ndër komunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkomunal dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror.
- Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë është nxjerrë me qëllim të përmirësimit të shpenzimeve buxhetore, kapitale dhe operative, menaxhimit financiar, kontabilitetit, përgjegjësisë buxhetore dhe sistemit të raportimit financiar për autoritetet publike dhe ndërmarrjet publike në Kosovë, si dhe për përshkrimin e kompetencave dhe detyrave të Ministrisë të Financave dhe autoriteteve të tjera publike rreth këtyre çështjeve.

Rrjedhimisht, problemi kryesor lidhur me zbatimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal qëndron në dispozitat jo adekuate ligjore, e cila rezulton me problemet serioze në fushëveprimin e financave lokale.

Figura3: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet

Efektet	Pamundësia e transferit të kompetencave nga niveli lokal në nivelin qendror duke përfshirë buxhetin dhe numrin e punëtorëve
	Pamundësia e financimit të nivelit të domosdoshëm të shërbimeve në arsim, shëndetësi dhe çështje sociale.

Koncept Dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal

	Pamundësia përfaqësimit të duhur të komunave në Komisionin e Granteve
Problemi kryesor	Dispozitat jo adekuate ligjore
Shkaqet	Mos ndryshimi i legjislacionit që do të adresonte zhvillimet e reja në dekadën e fundit në financat e pushtetit lokal
	Problemet në qartësinë e dispozitave ligjore në ligjin ekzistues
	Ligji ekzistues nuk ka përcaktuar obligime të qarta ligjore për ministritë e linjës për ushtrimin e kompetencave të tyre që ndërlidhen me financat e pushtetit lokal

Figura e mëposhtme liston palët e interesuara të identifikuar.

Figura4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palës së interesuar	Shkaku-qet me të cilat është e lidhur pala	Efektet me të cilat është e lidhur pala	Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)
Komunat	Me të gjitha shkaqet	Me të gjitha efektet	Në mënyrë të drejtpërdrejtë
MASHT	Vetëm me shkakun nr. 3	Vetëm me efektin nr. 2	Në mënyrë të drejtpërdrejtë

Koncept Dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal

MSH	Vetëm me shkakun nr. 3	Vetëm me efektin nr. 2	Në mënyrë të drejtpërdrejtë
MPMS	Vetëm me shkakun nr. 3	Vetëm me efektin nr. 2	Në mënyrë të drejtpërdrejtë
MF	Me të gjitha shkaqet	Me të gjitha shkaqet	Në mënyrë të drejtpërdrejtë
MTI/IT	Vetëm me shkakun nr. 3	Vetëm me efektin nr. 2	Në mënyrë të drejtpërdrejtë
MPB/AME	Vetëm me shkakun nr. 3	Vetëm me efektin nr. 2	Në mënyrë të drejtpërdrejtë
ZKM/AVUK	Vetëm me shkakun nr. 3	Vetëm me efektin nr. 2	Në mënyrë të drejtpërdrejtë

Kapitulli 2: Objektivat

Përmes kësaj politike synohet efikasiteti dhe efektiviteti më i madh i sistemit të financimit komunal. Ndër objektivat kryesor janë: sigurimi i qartësisë së financimit të funksioneve të centralizuara, sigurimi i përfaqësimit më efikas i interesave të komunave në Komisionin e Grantëve dhe ofrimi më i mirë i shërbimeve sociale, të arsimit dhe shëndetësisë. Të gjitha këto ndryshime planifikohen të arrihen duke filluar nga viti 2020, ndërsa përgjegjës kryesor do të jetë Ministria e Financave, kurse përgjegjës do të jenë edhe të gjitha organet tjera relevante në nivel qendror dhe komunal.

Këto objektiva nuk kanë ekzistuar më parë, por janë formuluar për herë të parë për nevojat e këtij koncept dokumenti.

Figure 5: Objektivat relevante të Qeverisë

Objektivi relevant	Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)
Sigurimi i qartësisë së financimit të funksioneve të centralizuara	Sipas këtij Koncept Dokumenti
Sigurimi i përfaqësimit më efikas i interesave të komunave në Komisionin e Grantëve	Sipas këtij Koncept Dokumenti
Ofrimi më i mirë i shërbimeve sociale, të arsimit dhe shëndetësisë	Sipas këtij Koncept Dokumenti

Kapitulli 3: Opsionet

Grupi Punues për hartimin e Koncept Dokumentit për Financat e Pushtetit Lokal ka shqyrtuar tri opsione kryesore për adresimin e të gjeturave në financat e pushtetit lokal. Dy opsionet e para të shqyrtuara, pra opsioni i asnjë ndryshimi dhe opsioni i përmirësimit të zbatimit të ekzekutimit, u konkludua që nuk janë të mjaftueshme për adresimin e problemeve të identifikuar në këtë Koncept Dokument. Opsioni i vetëm që adreson problemet e identifikuar është opsioni i hartimit të Projektligjit për Financat e Pushtetit Lokal.

Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim

Opsioni asnjë ndryshim do të ruante status quo-n dhe problemet ekzistuese do të vazhdojnë. Nëse nuk ndryshohet Ligji aktual dhe vazhdohet me zbatimin e ligjit ekzistues, problemet e identifikuar do të vazhdojnë të ekzistojnë. Rrjedhimisht, do të kemi problem me ushtrimin e funksioneve të cilat janë centralizuar kurse financimi i tyre do të vazhdoj nga buxheti komunal gjë që do të mbaj situatën të paqartë rreth asaj se kush është kompetent për ofrimin e shërbimit. Në të njëjtën kohë do të vazhdohej me përfaqësimin jo të duhur të interesave komunale në vendimmarrjen e Komisionit të Granteve. Gjithashtu, niveli i ndarjeve buxhetore nga komunat për shërbimet sociale do të mbetet në nivel jo të kënaqshëm. Po ashtu duhet theksuar faktin që ne vitin 2019 skadon obligimi ligjor për ndarjen e 2.7 % të grantit të përgjithshëm për komunat të cilat kanë me pak se 22,000 banorë. Andaj, ky opsion nuk është i rekomanduar.

Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit

Problemet që janë identifikuar në këtë Koncept Dokument janë kryesisht të ndërlidhura me bazën aktuale ligjore. Rrjedhimisht, çfarëdo përmirësimi në zbatimin dhe ekzekutimin e dispozitave përkatëse ligjore nuk do të prodhonte zgjidhje për problemet e identifikuar. Andaj, ky opsion nuk është i rekomanduar.

Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë

Përmes këtij opsioni synohet të arrihet ndryshimi i politikave ekzistuese, përmes miratimit të Ligjit të ri të Financave të Pushtetit Lokal, i cili do të siguronte:

- Qartësim të financimit të kompetencave që barten nga niveli lokal në atë qendror;
- Përmirësim të ofrimit të shërbimit si rezultat i qartësimin të financimit;
- Përmirësim i përfaqësimit të zërit të komunave në Komisionin e Granteve;
- Avancim i shërbimeve sociale dhe rezidenciale, përmes krijimit të grantit specifik për shërbime sociale;
- Krijtje të besueshmërisë në sistemin e financimit komunal;
- Definim i qartë i të hyrave vetjake komunale, si ato të mbledhura por edhe ato të pranuar nga komuna;
- Vendosje e kriterit të qartë për planifikimin e nivelit të hyrave vetjake komunale;
- Vendosje e kriterëve të qarta dhe transparente për investimet e nivelit qendror në atë lokal;
- Standarde dhe kritere më të avancuara për grantin specifik për arsim dhe shëndetësi;
- Krijtja e qëndrueshmërisë së financimit të komunave të vogla, përmes rritjes së pragut nga 140,000 euro në 200,000 euro, me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetjake të komunave më të vogla.

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Vlerësimet e dhëna më poshtë vlejné për të gjitha opsionet e paraqitura

Figure 6: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuaru për kategorinë e ndikimit

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuaru
Ndikimet ekonomike	Nuk do të ketë ndikime ekonomike
Ndikimet shoqërore	Nuk do të ketë ndikime të drejtpërdrejta në shoqëri. Në anën tjetër, opsioni i rekomanduar parasheh krijimin e grantit specifik për shërbime sociale, e cila do të ndikojë në mirëqenien shoqërore të një kategorie të njerëzve në nevojë.
Ndikimet mjedisore	Nuk do të ketë ndikime të drejtpërdrejta mjedisore. Në anën tjetër, opsioni i rekomanduar parasheh qartësimin e definicionit të të hyrave vetjake, ku parashihet të përfshijë edhe të hyrat e pranuar nga niveli qendror për komunat. Kjo do të qartësonte problemin ligjor lidhur me Ligji Nr. 05/L-044 për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij.
Ndikimet në të drejtat themelore	Nuk do të ketë ndikime të drejtpërdrejta në të drejtat themelore. Megjithatë, ndikimi mund të jetë jo i drejtpërdrejtë, nëpërmjet grantit social.
Ndikimi gjinor	Nuk do të ketë ndikime gjinore të drejtpërdrejta
Ndikimet e barazisë sociale	Nuk do të ketë ndikim në këtë fushë
Ndikimet tek të rinjtë	Nuk do të ketë ndikim në këtë fushë
Ndikimet në ngarkesën administrative	Nuk do të ketë ndikim në këtë fushë
Ndikimi i NMV-ve	Nuk do të ketë ndikim në këtë fushë

Opsioni i parë dhe opsioni i dytë nuk do të kenë ndikime pozitive në fushat e caktuara. Përkundrazi, do të kenë ndikim negativ në problemet e identifikuaru në këtë koncept dokument. Në anën tjetër, opsioni i tretë do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e sistemit të financave lokale dhe ndikime të tërthorta në fushat e sipërshënuara.

Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave

Grupi Punues për hartimin e këtij Koncept Dokumenti ka pasur në përbërjen e tij përfaqësim të nevojshëm për sigurimin e informatave të nevojshme për punën e këtij Koncept Dokumenti. Puna është udhëhequr nga Departamenti i Buxhetit, i cili ka siguruar informatat e përgjithshme dhe të veçanta të nevojshme, përmes Divizionit për Buxhet Komunal, i cili mbikëqyr dhe asiston në punën e përditshme financiare të komunave. Në anën tjetër, informatat dhe analizat specifike për grantin specifik në shëndetësi, arsim, çështje sociale,

Koncept Dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal

çështjet e zjarrfikësve dhe inspektorëve të llojeve të ndryshme, janë siguruar nga komunat dhe ministrinë e linjës/agjencitë përkatëse që kanë qenë në Grupin Punues. Po ashtu, edhe përfaqësuesit e Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe të pjesës tjetër të shoqërisë civile kanë kontribuar në të dhënat që janë bazuar në analizat e tyre.

Gjatë grumbullimit të dhënave për numrin e zjarrfikësve dhe inspektorëve (të tregut, sanitar, fitosanitar, veterinar) si dhe buxhetit përcjellës për kategori të ndryshme të shpenzimeve, janë evidentuar dallime kuantitative dhe kualitative në të dhënat e dërguara nga burime të ndryshme të institucioneve në nivel qendror dhe lokal, por Departamenti i Buxhetit ka ballafaquar këto të dhëna dhe ka bërë përpjekje të jetë sa më i kujdesshëm në vlerësim financiar.

Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Përveç përfaqësuesve të disa ministrive të linjës në Grupin Punues të Koncept Dokumentit, të cilët kanë punuar drejtpërdrejtë lidhur me problematikat e identifikuara, janë takuar edhe palët tjerë të interesit gjatë kësaj faze, të cilët ndikohen nga problemet e identifikuara. Një përmbledhje e takimeve është si në vijim:

- Në takim me përfaqësuesit e Agjencisë për Veterinari dhe Ushqim është marrë informata më detaje lidhur me problemin e inspektorëve veterinar, sanitar dhe fitosanitar, të cilët sipas ZKM/AVUK vlerësohet që duhet të barten në nivelin qendror, për të siguruar funksionimin adekuat të këtyre shërbimeve. Po ashtu, në takim u vë në pah që kjo problematikë është identifikuar edhe si e gjetur te Raporti i Vendit nga Komisioni Evropian, e cila duhet të adresohet.
- Në takim me përfaqësuesit e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, përkatësisht me përfaqësuesit e Inspektoratit të Tregut, është marrë informata që në nivel qendror janë të punësuar vetëm 2 inspektor të tregut dhe të tjerët janë në nivelin komunal. Edhe në këtë takim u potencua nevoja e bartjes së buxhetit dhe numrit të punëtorëve nga niveli lokal në këtë njësi. Po ashtu, në këtë takim u vë në pah që janë nënshkruar disa Memorandume për bartjen e inspektorëve të tregut nga niveli lokal për në nivelin qendror, por këto nuk kanë prodhuar asnjë efekt.
- Në takim me përfaqësuesit e Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është marrë informatë për problemet e këtij sektori dhe është diskutuar për nevojën e bartjes së numrit të punëtorëve dhe buxhetit të njësisë të zjarrfikësve nga niveli komunal për tek niveli qendror. Sfidë në këtë sektor mbetet trajtimi i aseteve (kryesisht ndërtesat) të sektorit të zjarrfikësve, përkatësisht nëse ato do të kalojnë nën pronësinë e AME-së ose je, si dhe investimet kapitale në këto godina. Lidhur me këtë pikë, ndërkohë është dhënë informatë nga MPB që janë arritur marrëveshjet me të gjitha komunat për shfrytëzimin/bartjen e aseteve.

Në këtë pjesë pasqyrohen komentet e pranuar gjatë konsultimeve paraprake dhe publike, si dhe vlerësimi i tyre nga Grupi Punues

Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve

Opsioni i parë dhe opsioni i dytë nuk do të kenë ndikime pozitive në fushat e caktuara. Përkundrazi, do të kenë ndikim negativ në problemet e identifikuara në këtë koncept dokument. Në anën tjetër, opsioni i tretë do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e sistemit të financave lokale dhe ndikime të tërthorta në fushat e sipërshënuara.

Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme

Zbatimi i opsionit të dytë kërkon mundësinë e qartësimin të dispozitave ligjore të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal përmes opinioneve ligjore, për aq sa lejohet, dhe eventualisht nëpërmjet ndonjë akti nënligjor, me qëllim të qartësimin dhe thjeshtësimin të procedurave.

Por, marrë parasysh që sistemi aktual i paraparë me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal nuk po mundëson funksionim efikas të financave të pushtetit lokal, Analizat e bëra dhe gjendja e verifikuar nga vet komunitat dhe organet qendrore në përgjithësi dhe Ministria e Financave në veçanti, rekomandojnë ndryshime të caktuara që të përmirësohet sistemi i funksionimit të financave lokale, përmes ndryshimeve ligjore. Disa nga pikat kryesore që kanë nevojë të adresohen janë si ne vijim:

1. Financimi i kompetencave të centralizuara - komunitat vazhdojnë të financojnë disa kompetenca të cilat tashmë janë bartur në nivel qendror si zjarrfikësit, inspektorët e tregut, inspektorët sanitar, veterinar dhe të bujqësisë-fitosanitar dhe të ngjashme. Ekziston nevoja për një përcaktim të qartë çfarë ndodh me financimin e atyre funksioneve të cilat barten nga niveli lokal në nivel qendror. Zgjidhja e kësaj çështjeje propozohet duke bërë zvogëlimin e grantit të përgjithshëm të komunave dhe bartjen e buxhetit dhe numrit të punëtorëve nga niveli lokal në nivelin qendror.
2. Definicioni i të hyrave vetjake komunale - Ligji ekzistues për financat e pushtetit lokal definon të hyrat vetjake komunale si të gjitha shumat e parave publike të cilat janë shqiptuar dhe janë mbledhur në mënyrë të ligjshme nga komuna. Është e nevojshme që ky definicion të pasurohet duke theksuar se të hyrat vetjake të komunave janë gjithashtu shumat e parave publike të cilat janë mbledhur dhe pranuar nga burimet e përcaktuara në Nenin 8 të këtij ligji. Kjo çështje ka të bëjë sidomos me rastet kur me ligje të veçanta parashihet alokimi i të hyrave nga niveli qendror në atë lokal.
3. Planifikimi i të hyrave vetjake komunale - ky planifikim të bëhet në përputhje me ligjin, duke marrë për bazë parametra të caktuar dhe duke marrë parasysh historinë e inkasimit të të hyrave vetjake komunale në tri vitet e kaluara, por duke vendosur një objektiv real të rritjes për çdo vit për çdo komunë me qëllim të rritjes së qëndrueshmërisë së financimit të komunave.

Koncept Dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal

4. Përfaqësimi efikas i komunave në Komisionin e Granteve – Dialogu në mes të qeverisë qendrore dhe asaj lokale rreth financave lokale është dizajnuar të zhvillohet përmes Komisionit të Granteve. Komisioni i Granteve duhet të fuqizojë përgatitjet teknike në mënyrë që të përkrahet një vendim-marrje e bazuar në informacion të mirë. Komunitat përfaqësuese në Komision të Granteve duhet të zhvillojnë konsultime paraprake me të gjitha komunitat para vendimmarrjes në Komision të Granteve.
5. Investimet e nivelit qendror në nivel komunal – Investimet në nivel komunal bëhen edhe nga niveli qendror. Madhësia e disa investimeve kapitale nënkupton që komunitat të mos kenë mundësi t'i mbulojnë ato, megjithatë, vendimet individuale të marra nga ministritë e caktuara gjenerojnë rrezik për investime disproporcionale nëpër Kosovë. Prandaj, me rastin e realizimit të projekteve nga niveli qendror në atë komunal kjo duhet të bëhet përmes kritereve të qarta, të drejta dhe transparente.
6. Granti specifik për shërbime sociale – parashihet të jetë grant me sistem të hapur dhe do të përfshijë financimin e shërbimeve sociale, rezidenciale dhe ditore, duke u bazuar në standardet minimale për shërbime sociale të përcaktuara nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale.
 - a. Komunitat të cilat kanë të themeluara dhe krijojnë qendra rezidenciale apo ditore për ofrimin e shërbimeve sociale, sipas kritereve të përcaktuara dhe pëlqimit të MPMS-ja do të marrin një financim për shërbimet rezidenciale apo ditore me aprovim nga Komisioni Granteve. Shuma e mbështetjes financiare do të përfshijë koston operative për funksionim të asaj qendre dhe koston e shpenzimeve për ofrimin e shërbimeve rezidenciale apo ditore sipas standardeve minimale.
 - b. Komunitat do të pranojnë një Grant specifik për shërbime sociale me aprovim të Komisionit të Grantëve, i cili përdoret për financimin e koston së ofrimit të standardeve minimale për shërbime sociale dhe familjare. Formula e financimit për këtë grant do të bazohet në disa indikatorë social dhe numrin e kategorive sociale të regjistruar në Qendrat për Punë Sociale që kanë nevojë dhe parashirojnë kërkesë për shërbime sociale. Implikimi buxhetor për krijimin e grantit specifik për shërbime sociale do të adresohet duke zvogëluar grantin e përgjithshëm. Të gjitha bashkëpagesat, tarifatat dhe taksat për shërbimet sociale komunale konsiderohen si të hyra vetjake të komunës, të cilat janë të hyra të dedikuara dhe që mund të shfrytëzohen nga institucionet përkatëse të shërbimeve sociale.
7. Granti specifik për Arsim dhe granti specifik për Shëndetësi – sistemi dhe rregullat ekzistuese për ndarjen e granteve specifike për Arsim dhe Shëndetësi nuk janë treguar të përshtatshme dhe adekuate. Prandaj, nevojitet zhvillimi dhe avancimi i standardeve dhe kritereve nga ministritë e linjës për këto dy lloj grantesh.
8. Qëndrueshmëria e komunave të vogla – Me qëllim të sigurimit të ofrimit të nivelit minimal të shërbimeve komunale, Qeveria e Republikës së Kosovës për një periudhë kalimtare deri në vitin 2019, ndan 2.7% të grantit të përgjithshëm për komunitat që kanë popullsi më pak se njëzet e dy mijë (22,000) banorë. Prandaj, sistemi i financimit të komunave duhet të sigurojë një zgjidhje të qëndrueshme për këtë çështje. Me këtë koncept dokument propozohet që të bëhet zgjidhje e tillë që mundeson rritjen e pragut

Koncept Dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal

nga 140,000 euro ne 200,000 euro, pasi qe me sistemin ekzistues, me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetjake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë pranon për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë.

Figura7: Plani i zbalimit për Opsionin 3

Qëllimi i politikës	Hartimi i Projektligjit për Financat e Pushtetit Lokal							Shifra pritshme e koste
Objektivi strategjik	Sigurimi i infrastrukturës së qartë ligjore për financat e pushtetit lokal							
	Projektligji për Financat e Pushtetit Lokal, i sponsoruar nga Ministria e Financave, nëpërmjet Departamentit të Buxhetit							
Sigurimi i qartësisë së financimit të funksioneve të centralizuara	Bartja e buxhetit dhe numrit të punëtorëve të rasteve të identifikuar		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës
		Bartja	MPB-AME MTI-II ZKM-AVUK	Nuk ka aktivitet	Nuk ka aktivitet	Nuk ka aktivitet	Nuk ka aktivitet	MF/DB
	Bartja e buxhetit dhe numrit të punëtorëve të rasteve që mund të lindin pas miratimit të Ligjit.		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	MF/DB
		Bartja	Nuk ka aktivitet	Sipas nevojës	Sipas nevojës	Sipas nevojës	Sipas nevojës	
Sigurimi i përfaqësimit më efikas i interesave të komunave në Komisionin e Granteve	Sigurimi i konsultimit para votimit në Komisionin e Granteve	Konsultimi	Ka aktivitet	Ka aktivitet	Ka aktivitet	Ka aktivitet	Ka aktivitet	MF/DB Komunitat

Koncept Dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal

Ofrimi më i mirë i shërbimeve sociale, të arsimit dhe shëndetësi së.	Sigurimi i shërbimeve sociale	Siguri mi	Sigurohet buxheku për herë të parë	Vazhdon zbatimi	Vazhdon zbatimi	Vazhdon zbatimi	Vazhdon zbatimi	MF MPMS Komunitat	
	Zhvillimi i mëtejshëm i grantit për arsim	Zhvillimi	Sigurohet zhvillimi në vitin e parë	Vazhdon zbatimi	Vazhdon zbatimi	Vazhdon zbatimi		MF MASHT Komunitat	
	Zhvillimi i mëtejshëm i grantit për shëndetësi	Zhvillimi	Sigurohet zhvillimi në vitin e parë	Vazhdon zbatimi	Vazhdon zbatimi	Vazhdon zbatimi		MF MSH Komunitat	

Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet

[Jepni një paraqitje të shkurtër narrative të tre opsioneve. Gjithashtu paraqitni opsionin e zgjedhur dhe arsyt kryesore përse është zgjedhur.]

Figura8: Krahasimi i opsioneve

Metoda e krahasimit:									
	Opsioni 1: Asnjë ndryshim			Opsioni 2: Përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit			Opsioni 3: Hartimi i Projektligjit të ri për Financat e Pushtetit Lokal		
Ndikimet relevante pozitive	Nuk do të ketë ndikim pozitiv			Nuk do të ketë ndikim pozitiv			Do të adresojë të gjitha problemet e identifikuara deri më 1 janar 2020.		
Ndikimet relevante negative	Do ta ruaj status quon me problemet ekzistuese			Në masë të madhe do ta ruaj status quon me problemet ekzistuese			Nuk do të ketë asnjë ndikim negativ		
Kostot relevante	Nuk do të krijojë kosto shtesë			Nuk do të krijojë kosto shtesë			Do të krijojë kosto shtesë, e cila do të planifikohet.		
Vlerësimi i ndikimit të pritshëm buxhetor	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3
	0	0	0	0	0	0			
Përfundimi	Nuk rekomandohet			Nuk rekomandohet			Opsioni i rekomanduar		

Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm

Koncept Dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal

Sipas të gjitha analizave të bëra nga ky Koncept Dokument, i vetmi opsion që garanton adresimin e problemeve të identifikuara në fushën e financave të pushtetit lokal është adresimi me ndryshime ligjore, meqë shkaku kryesor i problemeve të identifikuara janë dispozitat ligjore që krijojnë efekte në këtë sistem.

Plani për zbatimin e këtij Koncept Dokumenti, me kusht që aprovohet me opsionin e rekomanduar, është si në vijim:

Veprimi	Afati kohor
1. Miratimi i Koncept Dokumentit për Financat e Pushtetit Lokal	K4 2018
2. Hartimi i Projektligjit për Financat e Pushtetit Lokal	K1 2019
3. Aprovimi Projektligjit për Financat e Pushtetit Lokal në Qeverinë e Republikës së Kosovës	K2 2019
4. Aprovimi Projektligjit për Financat e Pushtetit Lokal në Kuvendin e Republikës së Kosovës	K3 2019
5. Hyrja në fuqi e Projektligjit për Financat e Pushtetit Lokal	1 janar 2020
6. Zbatimi i Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal	1 janar 2020 -

Sipas kërkesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 22.08.2018, Ministria e Financave do të mundohet që të procedojë këtë Projektligj sipas procedurave të përshpejtuara.

Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin

Plani i veprimit për zbatimin e opsionit të rekomanduar të këtij Koncept Dokumenti do të reflektohet në Planin e Punës së Ministrisë së Financave dhe zbatim i këtij plani do të monitorohet nga menaxhmenti i Ministrisë së Financave, nëpërmjet Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave.

Koncepti Dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal

Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimi kryesor	A pritët të ngodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur ndikimit	Përfitim i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Vendet e punës ¹	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		Jo			
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		Jo ²			
	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?		Jo			
	A do të ndikojë në lehtësimin e gjeljes së një vendi të punës?		Jo			
	A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes?		Jo			
Bërja e biznesit	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?		Jo			
	A do të lejohen në treg produkte të caktuara?		Jo			
	A do të detyrohen bizneset të mbyllën?		Jo			
	A do të krijohen biznese të reja?		Jo			
	A do të detyrohen bizneset t'i përbushin detyrimet e dhënies së informatave të reja?		Jo			
Ngarkesa administrative	A janë thjeshtuar detyrimet e dhënies së informatave për bizneset?		Jo			

¹Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime shoqërore.
²Parimisht nuk pritët të rritet numri aktual i vendeve të punës, sepse parashihet bartja e buxhetit përkatës dhe numrit të punëtorëve nga komunitat tek ministratë përkatëse: MPB/AME, MTI/Inspektorati i Tregut, ZKM/AVUK. Parashihet të bëhet bartja e zjarifikësve, inspektorëve të tregut, inspektorëve sanitar, veterinar, dhe fitosanitar. Gjatë konsultimeve paraqite me komunat dhe organet përkatëse qendrore rreth këtij draft koncept-dokumenti do të konfirmohet saktësisht nëse ka patur ndryshime të stafit në komuna lidhur me këto kompetenca.

Koncepti Dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal

Tregtia	A pritjet të ndryshojnë flukset aktuale të importit?	Jo			
	A pritjet të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit?	Jo			
Transporti	A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave?	Jo			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra?	Jo			
Investimet	A pritjet që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja?	Jo			
	A pritjet që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet?	Jo			
	A do të rriten investimet nga diaspora?	Jo			
	A do të zvogëlohen investimet nga diaspora?	Jo			
	A do të rriten investimet e huaja direkte?	Jo			
	A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?	Jo			
	A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike?	Jo			
	A do të ulët çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike?	Jo			
	A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi?	Jo			
	A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen?	Jo			
Ndikimi në NVM	A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM?	Jo			

Koncept Dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal

Çmimet dhe konkurrenca	A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?	Jo		
	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?	Jo		
	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?	Jo		
	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?	Jo		
	A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit?	Jo		
	A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar?	Jo		
Ndikimet ekonomike rajonale	A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike?	Jo		
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?	Jo		
Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik				

Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

Kategoria e ndikimeve shoqërore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Vendet e punës ³	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?	Jo	Jo	I lartë/i ulët		
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?	Jo	Jo			
	A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit?	Jo	Jo			
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?	Jo	Jo			
	A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjëves së një vendi të punës?	Jo	Jo			
	A janë ndikimet shoqërore të përqunduara në një rajon apo qytete të veçanta?	Jo	Jo			
Ndikimet shoqërore rajonale	A ndikohen të drejtat e punëtorëve?	Po	Jo	Shumë i ulët	Shumë i ulët	Mesatar
	A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte të rrezikshme?	Jo	Jo			
	A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve?	Jo	Jo			
	A do të ketë ndikim mbi vlefërinë?	Jo	Jo			
	A ndikohet gjasja në skemat e mbrojtjes sociale?	Po	Jo	Mesatar	I ulët	Mesatar
	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore?	Jo	Jo			
Përfshirja sociale						

³Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime ekonomike.

Koncept Dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal

	Po	Mesatar	Mesatar	Mesatar
A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?	Po		Mesatar	Mesatar
A do të ketë ndikim në arsimin fillor?	Po		Mesatar	Mesatar
A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?	Po		Mesatar	Mesatar
